

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbim

PËR ARGUMENTIMIN E REALIZIMIT TË PROCEDURËS NË NJË KONTRATË

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Ruajtja dhe Siguria Fizike në roje private dhe shoqërimi i vlerave monetare për UKT sh.a”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): sherbime roje/ sherbime me roje.

VLERA E FONDIT LIMIT 69,623,583.59 (gjashtembedhjete milion e nenteqind e nentedhjete e gjashte mije) lekë pa tvsh .

Vlera e fondit Limit ne monedhen nderkombetare Euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise është 659.126,986 (gjashteqind e pesedhjete e nente mije e njeqind e njezet e gjashte presje nenteqind e tetedhjete e gjashte) euro pa tvsh.

Kursi zyrtar i kembimit për monedhën euro sipas Bankes te Shqiperise datë 10.10.2023 është 105.63

Në bazë të nenit 39, pika 1, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **SH.A. Ujësjiellës Kanalizime Tiranë**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin e mosndarjes së procedurës në lote, me përmbajtjen si më poshtë:

Bazuar në Projekt Buxhetin nr. 14 prot, datë 29.12.2022, kjo procedurë është miratuar si zë I vetëm pra duke përfshirë në një kontratë edhe shërbimin e ruajtjes së objekteve të UKT me roje sigurie edhe transportin e vlerave monetare.

Kjo kontratë është realizuar në një formë të tillë për arsye sigurie.

Të dy shërbimet që ne kërkojmë janë të ndërlidhura dhe bashkëveprojnë me njëra tjetrën, pasi në një objekt që kërkohet të ruhet me roje sigurie, njëkohësisht kryhet edhe transport vlerash monetare. Ofrimi i këtyre shërbimeve nga një kompani sigurie e vetme çon sigurinë në një nivel më të lartë.

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 parashikohet shprehimisht se: “*Qëllimi i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.
2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 14, Operatorët ekonomikë, prashikohet shprehimisht se:

1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.
2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.
Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.
3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

Në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, I ndryshuar Kreu XI, neni 88, është parashikuar:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.
2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.
3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.
Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Referuar sa më sipër legjislacioni i prokurimit publik njeh gjithashtu të drejtën e shoqërive për t'u bashkuar për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

Në rastin konkret, ndarja në lote e procedurës së prokurimit, do të komplikonte menaxhimin e minikontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësive. Ofrimi i këtyre shërbimeve nga një kompani sigurie e vetme rrit sigurinë në një nivel më të lartë.

Theksojmë se kjo procedurë është një procedurë e cila realizohet në mënyrë të përvitshme nga UKT sh.a dhe për vetë rendësinë dhe specifikat e veçanta që ka realizimi i këtij shërbimi.